



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:093685

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05588639

P.nr.158/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I...H... nga fshati Zh... Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 e nenin 77 të KPPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.353/2024 të datës 12.03.2024, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 01.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën PP.II.nr. 353/2024 të datës 12.03.2024, andaj kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit: I... H..., nga babai R..., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin Zhegër, K. Gjilan, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me shifër të konsumatorit 9..... dhe nr.personal.....

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

Nga datë 07.11.2023¹ e deri më dt.16.12.2023, në fshatin Zhegër, K.Gjilan, në shtëpinë në shfrytëzim të tij I pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka vjedhë shërbime komunale të energjisë elektrike duke shfrytëzuar në vazhdimësi energjinë elektrike e cila nuk është matur, në atë mënyrë që për shkak të borxhit të papaguar të njëjtit i është çkyçur energjia elektrike dhe i është konfiskuar

njësori elektrik dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike në terren nga ekipa e kontrollit të KEDS, është vërtetuar se i njëjti në mënyrë të paautorizuar është idhur direkt në rrjetin elektrik duke anashkaluar matjen dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme, ka dëmtuar KEDS-in, distrikti në Gjilan në shumë 94.67 € .

Me këtë ka kryer veprën penale të vazhdueshme vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 e nenin 77 të KPRK-së,

Prandaj, në bazë të nenit 4,31,38,40,43,të KPRK-ës si dhe të nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që i akuzuari . dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **100(njëqind-euro) €**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm,ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.353/2024 të datës 12.03.2024, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 e nenin 77 të KPRK-së dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me besueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetem gjykues me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si vijon: procesverbali nr.2190202 i dt.16.12.2023, fotografitë e njësorit elektrik për gjendjen në terren, kalkulimi i RH i dt.18.12.2023, fatura DGLHP2313811 e dt.18.12.2023.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 495 paragrafi 1,2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.158/2024 me datë 01.04.2024

Gjyqtari

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqes kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.